



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 4718 Prot.,

Lezhë, më 16.04.2026

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit nr.649, datë 16.10.2024. Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, VKB- së nr. 112 datë 29.06.2021 “Për krijimin e Shoqërisë “Lezha Invest” SH.P.K si Përsone Juridik në Pronësi të Bashkisë Lezhë”, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 10 datë 07.04.2025 “Për miratimin e planit të menaxhimit të plazheve publike në Bashkinë Lezhë”, Vendimit nr 70 datë 06.02.2026 “Për miratimin e strukturës dhe emërtimet e pozicioneve, klasat për cdo pozicion pune për administratën e Lezha Invest Shpk”, shkresës 12/1 prot., datë 01.04.2026, protokolluar nga ana jonë me 4189 prot., datë 02.04.2026, me lëndë “Kërkesë për mbështetje në rekrutimin e stafit me kohë të pjesshme/sezonal për menaxhimin dhe administrimin e plazheve publike për sezonin turistik 2026”, të Lezha Invest Sh.p.k, Bashkia Lezhë dhe Lezha Invest Sh.p.k, njofton për shpalljen e procedurave për vende të lira pune për pozicionet:

- Inspektor Kontrolli me kohë të pjesshme (6 punonjës)
- Punonjës plazhi me kohë të pjesshme (50 punonjës)
- Vrojtues plazhi (me kohë të pjesshme (25 punonjës)

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Inspektor Kontrolli me kohë të pjesshme, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Është përgjegjës për stacionet e plazhit nën menaxhim, duke kontrolluar punonjësit që administrojnë stacionet e plazhit dhe vrojtuesit e plazhit (lifeguard), duke kontrolluar pastrimin pastrimin dhe shërbimin e ofruar ndaj pushuesve.
- Analizon mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrave nga ana e Sektorit, informon drejtpërdrejt Administratorin mbi punën kryer si dhe paraqet çdo problematike sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi;

- Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregullores në fuqi si dhe të planeve të punës të miratuara nga Administratori i Lezha Invest Sh.p.k;
- Mbikëqyr respektimin e kuadrit rregullator nga ana e punonjësve;
- Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Administratori i Lezha Invest Sh.p.k,në përputhje me misionin dhe objektivat e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme “Për miratimin e planit të menaxhimit të plazheve publike në Bashkinë Lezhë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin punonjës plazhi me kohë të pjesshme, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Punonjësi i plazhit është përgjegjës për stacionin e plazhit. Ka për detyrë mirëmbajtjen, administrimin dhe pastrimin e stacionit të plazhit ku përfshihen çadrat dhe ambienti përreth tyre brenda stacionit të plazhit.
- Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregullores në fuqi si dhe të planeve të punës të miratuara nga Administratori i Lezha Invest Sh.p.k;
- Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Administratori i Lezha Invest Sh.p.k,në përputhje me misionin dhe objektivat e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme “Për miratimin e planit të menaxhimit të plazheve publike në Bashkinë Lezhë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Vrojtues plazhi (Lifeguard) me kohë të pjesshme, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Duhet të jetë i angazhuar vetëm në shërbim të vrojtimit-shpëtimit
- Gjatë shërbimit, duhet të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyrë të kuqe.
- Duhet të lajmërojë pranë organeve kompetente, në rastet kur verifikohen kundravajtje ne territorin e stacionit te plazhit dhe në hapësirën ujore perballe tij.
- Duhet të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit.

- Duhet të bejë zëvendesimin e materialeve të konsumuara në kutinë e ndihmës së shpejte mjekësore, si edhe të mbajë në efikasitet mjetet e shpëtimit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të zotërojnë leje aktive nga institucionet përgjegjëse për ushtrimin e këtij pozicioni pune sipas legjislacionit në fuqi për vrojtuesit e plazhit.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin pranë Sportelit të Zyrës me një Ndalesë në Bashkinë Lezhë si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar
- b- Fotokopje të diplomës e noterizuar;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Dëshminë e Penalitetit;
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 04.05.2026.

Rezultatet për fazën e verifikimit

Pas dorëzimit të dokumentacionit, Bashkia Lezhë do të përcjellë dokumentacionin pranë Shoqërisë Lezha Invest Sh.p.k.

